



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1418 /3 prot.

Datë 06/07/2022

V E N D I M
Nr. 636/2022

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|------------------|------------|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Fiorent Zguro | Nënkryetar |
| Kreshnik Ternova | Anëtar |
| Anila Malaj | Anëtar |

Në mbledhjen e datës 06/07/2022, me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE ankimues “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK & “ENGINEERING CONSULTING GROUP” SHPK, në procedurën e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Projekt për rikonstruksionin e gjimnazit “Gramoz Palushit” Paskuqan”, me nr. REF-32543-06-10-2022, me fond limit 5,388,743 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues: BOE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK & “ENGINEERING CONSULTING GROUP” SHPK
Rruga "Sami Frashëri", pallati Bjorn, kati 11, 1019, Tiranë
Rruga "Arkitekt Kasemi", Pallati 22, Brryli, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Kamëz
Adresa: Blv. "Nënë Tereza", nr.492, Kamëz.

Baza Ligjore: *Ligji nr. 162/2020, "Për Prokurimin Publik", Ligji nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", neni 42 e vijues". Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorëve ekonomik ankimes, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimesit dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik“, ankimesit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimesi ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik” dhe ligjin nr. 97/2020 “Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 42 e vijues.

I.3. Ankimesi nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.06.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Projekt për rikonstruksionin e gjimnazit “Gramoz Palushit” Paskuqan”, me nr. REF-32543-06-10-2022, me fond limit 5,388,743 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

II.2. Në datën 23.06.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.3. Në datën 27.06.2021, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezultoi si më poshtë vijon:

- | | |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------|
| 1. B.O.E. “ILLYRIAN CONSULTING GROUP” SH.P.K, & “ENGINEERING CONSULTING GROUP” | Skualifikuar; |
| 2. ” INSTITUTI DEKLIADA – ALB” SHPK | Kualifikuar; |
| 3. B.O.E. “ZENIT&CO”SH.P.K, & “GRAMA” SH.P.K | Kualifikuar; |

II.4. Në datën 01.07.2022, operatori ekonomik ankimes “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK & “ENGINEERING CONSULTING GROUP” SHPK., në procedurën e prokurimit e prokurimit të sipërcituar.

II.5. Në datën 05.07.2022 autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, protokolluar me tonën me nr. 1418/2 prot., datë 06.07.2022 ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorëve ekonomik ankimes, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Në datën 13.06.2021 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”, me objekt “Projekt për rikonstruksionin e gjimnazit “Gramoz Palushit” Paskuqan”, me nr. REF-32543-06-10-2022, me fond limit 5,388,743 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

III.1.1. Nga shqyrtimi i informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se në datën 27.06.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

III.1.2. Në datën 01.07.2022, operatori ekonomik ankimes “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK., ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik duke kundërshtuar vendimin e komisionit të vlerësimit të ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK & “ENGINEERING CONSULTING GROUP” SHPK., në procedurën e prokurimit e prokurimit të sipërcituar.

III.1.3. Në datën 06.07.2022 autoriteti kontraktor me anë të postës elektronike, protokolluar me tonën me nr. 1418/2 prot., datë 05.07.2022 ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 42, pika 10, të ligjit nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore” është parashikuar: “Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim Brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të këtij akti. Për efekt kohe, komunikimi midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet nëpërmjet e-mail-it zyrtar. 4 Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.”

III.1.5. Referuar informacionit të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, dërguar nga autoriteti kontraktor, rezulton se ky i fundit ka kryer vlerësimin e ofertave dhe ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës, lidhur me këtë vlerësim, në datën 27.06.2022. Referuar ligjit nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, parashikohet se ankimi administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dorëzohet me shkrim brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve

fitues. Në interpretimin gjuhësor të dispozitës së sipërcituar, afati i ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis nga dita e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se operatori ekonomik ankimues nuk e ka ezuaruar ankimin administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda afatit të parashikuar nga neni 42 pika 10 të ligjit nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, pasi ankimi i dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 01.07.2022 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga ligji i sipërcituar, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë Komisionit të Prokurimit Publik nis nga dita e kur operatori ekonomik është njoftuar nga autoriteti kontraktor mbi vendimin e KVO-së (27.06.2022) dhe duhet dorëzuar pranë KPP-së brenda 3 ditëve (29.06.2022). Në rastin konkret, ankesa e paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik prej operatorit ekonomik ankimues “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK, është pas përfundimit të afatit të parashikuar nga neni 42 pika 10 të ligjit nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, duke mos u legjitimuar racione temporis në dorëzimin e ankesës.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementet e domosdoshëm të ankesës*”, ndaj dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, si pasojë e mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike lidhur me rindërtimin dhe përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimimi, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”. Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 24 dhe vijues, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, nenit 42 e vijues të Ligjit Nr. 97/2020 „Për miratimin e Akti Normativ me fuqinë e ligjit, nr. 9, datë 16.12.2019 “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nenit 78 të Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” SHPK, për procedurën e prokurimit “*“E kufizuar - Marrëveshje Kuadër në Kuadër të Procesit të Rindërtimit”*”, me objekt “*Projekt për rikonstruksionin e gjimnazit “Gramoz Palushit” Paskuqan*”, me nr. REF-32543-06-10-2022, me fond limit 5,388,743 lekë (pa TVSH), zhvilluar nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

